



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:268008

Datë: 21.10.2024

Numri i dokumentit: 06368224

KA.nr.695/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Apartment 197 Group” SH.P.K., me NUI 810071134 me seli në Prishtinë të cilin sipas autorizimit e përfaqëson zyra e avokatisë “Koci & Vokshi” SH.P.K me adresë në rrugën “Robert Doll”, nr.19, Prishtinë kundër të paditurit Ministria e Financave, Punës dhe Tranfereve, Komisioni i Ankesave me seli në Prishtinë, përfaqësuar sipas autorizimit nga Avokatura Shtetërore, për shkak të anulimit të vendimit të datës 19.04.2021 pas mbajtjes së seancës të shqyrtimit kryesor publik me datë 07.10.2024, me pjesëmarrje të përfaqësuesit me autorizim të paditësit, ndërsa në mungesë të përfaqësuesit të paditurës, me datë 21.10.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit “Apartment 197 Group” SH.P.K., me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Tranfereve, Komisioni i Ankesave me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit të datës 19.04.2021 të lëshuar nga e paditura me propozim që të obligohet e paditura të merr vendim për bartjen e mjeteve të subvencioneve në shumë të përgjithshme prej 13,920.00 euro, **si e pa bazuar** .
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Me datë 30.11.2021, në Gjykatën Themelore të Prishtinës Departamenti për Çështje Administrative, paditësi “Apartment 197 Group” SH.P.K me seli në Prishtinë ka parashtruar padi e evidentuar me nr. A.2826/21, kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Tranfereve - Komisioni i Ankesave, me seli në Prishtinë me propozim që Gjykata ta aprovoj si të bazuar kërkesëpadija e paditësit, të anulohet vendimi i datës 19.04.2021 i Komisionit të Ankesave të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, të obligohet e paditura të merr vendim për bartjen e mjeteve të subvencioneve në shumë të përgjithshme prej 13,920.00 euro sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe në përputhje me kërkesën e paditësit dhe të obligohet e paditura që paditësit t’ia paguaj shpenzimet procedurale.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr. 695/22.
3. Gjykata mbajti seancë të shqyrtimit kryesor publik konform nenit 41 të LKA-së më datë 07.10.2024, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditësit avokate Fjollë Ibrahim, sipas autorizimit të përgjithshëm nga zyra e avokatëve “Koci &Vokshi” SH.P.K ndërsa në mungesë të përfaqësuesit të paditurit nga avokatura shtetërore, të ftuar në mënyrë të rregullt, të njëjtit ftesën për në seancë e kanë pranuar më datë 27.09.2024, ndërsa më datë 04.10.2024 kanë dorëzuar parashtrësë përmes së cilës kanë arsyetuar mungesën me propozim të mbahet seanca e shqyrtimit kryesorë.

Pretendimet e palës paditëse

4. Përfaqësuesi i paditësit në pretendimet e dhëna në padi ka theksuar se Qeveria e Republikës së Kosovës më datë 28.09.2020 ka nxjerr Vendim Nr. 10/33, të plotësuar dhe ndryshuar me vendimet Nr. 14/34 dhe Nr. 01/35 për ndarjen e mjeteve buxhetore për subvencionimin për linjën e pagave për bizneset aktive, bazuar në numrin e të punësuarve të deklaruar në deklaratën e tatimit në pagë të muajit Dhjetor 2019 dhe që i plotësojnë dy kritere: (1). të kenë statusin e tatimpaguesit aktiv në muajin Korrik 2020 në Agjencinë Tatimore të Kosovës (tutje referuar ATK), dhe të kenë të dorëzuar deklaratën vjetore, tremujore dhe deklaratën për tatimin e mbajtur në burim në paga sipas legjislacionit në fuqi, (2). për bizneset aktive që deklaratën tatimore nuk e kanë dorëzuar përmes EDI,

kërkohen dëshmitë bankare se pagesa e detyrimeve tatimore është realizuar para datës 28.09.2020 në përputhje me vendimin Nr. 03/59 nën par. 2.

5. Me datë 07.10.2020 Ministria e Financave ka njoftuar bizneset se pagesa për biznese do të realizohet një herë dhe nuk do të ketë nevojë për aplikim nga kompanitë, sepse do të kualifikohen me automatizëm nëse do i plotësojnë kriteret e përcaktuara në vendimin e Qeverisë Nr. 10/33 të datës 28.09.2020. Ka theksuar se pasi që paditësi nuk ka pranuar mjetet sipas vendimit të Qeverisë më datë 19.01.2020 përmes emailit ka parashtruar ankesë në Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave në Ministrinë e Financave sa i përket subvencionimit për linjën e pagave sipas kriterëve të masës 1.1 të Vendimit të Qeverisë Nr. 10/33 të datës 28.09.2020, ku do të përfitonin 13,920 euro, ndërsa më datë 12.01.2021 paditësi ka pranuar e-mail nga Komisioni i Ankesave që të dorëzoj deklaratën vjetore tatimore, ndërsa paditësi deklaratën tatimore e ka dërguar më datë 13.04.2021 dhe formularin e deklarimit vjetor për vitin 2019. Tutje, ka shtuar se paditësi ka kërkuar nga Ministria nxjerrjen e aktit administrativ të miratuar në heshtje ndërsa e paditura më datë 25.10.2021 është përgjigjur në këtë kërkesë të paditësit se kërkesa sa i përket subvencionimit të linjës së pagave është refuzuar më datë 19.04.2021 duke e bashkangjitur edhe vendimin e kundërshtuar.
6. Sipas paditësit vendimi i kundërshtuar me padi të cilin paditësi e ka pranuar më datë 25.10.2021 e paditura pa të drejtë ka pretenduar se paditësi nuk i ka plotësuar dy kriteret e kërkuara për të përfituar nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike. Ka shtuar se fakti se paditësi i plotëson kriteret e caktuara sipas vendimit të Qeverisë argumentohet përmes letërkëmbimeve në mes të paditurit dhe paditësit, më datë 12.04.2021 paditësi ka pranuar e-mail nga Komisioni i Ankesave se ankesa është duke u shqyrtuar dhe duhet të dorëzoj deklaratën vjetore tatimore PD ose CD (varësisht nga statusi i biznesit), andaj paditësi duke vepruar sipas sugjerimeve të Komisionit të Ankesave më datë 13.04.2021 ka dorëzuar Formularin e deklarimit vjetor për vitin 2019 andaj nga këto letërkëmbime përmes email dhe provat e bashkangjitura aty qartazi rezulton se paditësi i ka plotësuar kriteret e nevojshme për të përfituar nga subvencionimi i linjës së pagave.
7. Sipas tij, vendimi i kundërshtuar përmban edhe shkelje esenciale si pasojë e arsytimit të mangët dhe atë në kundërshtim me dispozitën e nenit 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që e paditura nuk ka marr për bazë të

gjitha dëshmitë që ka pasur në dispozicion në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se paditësi kishte deklaruar të punësuarit për muajin dhjetor 2019, përkatësisht 48 punëtor dhe kjo gjë mund të vërtetohet nga të dhënat e disponueshme pranë ATK-së, megjithatë e paditura kishte ardhur në përfundim se paditësi nuk kishte dorëzuar deklaratën për tatimin e mbajtur në burim në paga si dhe paditësi nuk kishte dorëzuar dëshmi se pagesa e detyrimeve tatimore është realizuar para datës 28.09.2020 (datë kjo e nxjerrjes së vendimit të qeverisë) ani pse si dëshmi kishte pasur dy fletëpagesa ku figurojnë datat e deklaramit në këtë rast Janar 2020. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, të anulohet vendimi i datës 19.04.2021 i Komisionit të Ankesave të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, të obligohet e paditura të merr vendim për bartjen e mjeteve të subvencioneve në shumë të përgjithshme prej 13,920.00 euro sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe në përputhje me kërkesën e paditësit dhe të obligohet e paditura që paditësit t’ia paguaj shpenzimet procedurale.

Kundërshtimet e palës së paditur

8. Përfaqësuesja e të paditurës në pretendimet e dhëna përmes përgjigjes në padi, ka deklaruar se e kundërshton në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit duke theksuar se pala ankimore tani në cilësinë e paditësit nuk i kishte plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr. 10/33,14/34 dhe 01/35. Tatim paguesi tani këtu paditësi nuk e kishte dorëzuar deklaratën tatimore vjetore/tremujore apo deklaratën për tatim të mbajtur në burim nga paga deri më 28.09.2020 ashtu siç kërkohet në Vendimin nr. 10/33, pika 1.1, nuk e kishte dorëzuar deklaratën tremujore përmes Sistemit Elektronik EDI, ku është kërkuar dëshmia bankare se page e detyrimeve tatimore është realizuar para datës 28.09.2020, në përputhje me Vendimin nr. 03/59 nën par. 2.2.
9. Ka theksuar se bazuar në datën e regjistrimit të këtij personi juridik tani në cilësinë e paditësit 11.09.2017 ky tatimpagues për të përfituar subvencionin është dashur të ketë të deklaruar në ATK deri më datë 28.09.2020 deklaratën vjetore CD për Tatim në të ardhura të Korporatave për periudhën 2019, mirëpo tatim paguesi këtë deklaratë e ka dorëzuar më datë 13.04.2021, andaj vendimi i atakuar është marr konform të gjitha dispozitave ligjore në fuqi dhe në mënyrë të drejtë. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet si e pa

bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe të lë në fuqi vendimin e kontestuar me padi si të ligjshëm.

Provat e administruara

1. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Formular i deklarimit vjetor për periudhën e deklarimit 2019, në të cilën përshkruhet deklarimi i tatimit për periudhën e vitit 2019 nga paditësi, ku të ardhurat neto nga kutia me numër 78 bartet në kutinë 10 të ATK-së, në shumë prej 20,822.09 eur.; Fletë pagesa, pasqyra e kontributeve për pension dhe formulari i dërgesës me datë 15.01.2020, nga konstatohet se paditësi në Ministrinë e Financave ka paguar shumën 1,485,56 euro; Fletëpagesës për periudhën 12/2019, paditësi në Ministrinë e Financave ka paguar shumën 862.33 euro në emër të tatimit; Dëshmia e pagesave nga TEB Banka me datë 15.01.2020, në të cilën përshkruhet se janë debituar 1,218.60 euro dhe 707.58 euro nga llogaria e paditësit Apartament 197 Group LLC; Pasqyra mujore në tatim në burim dhe kontributet në pension për periudhën 2012/2019, në të cilën përshkruhet numri i punëtorëve të paditësit në total 48, të ardhura mujore vijnë në shumë prej 27,036.61 euro, mbajtje në burim e kontributeve të të punësuarve në shumë prej 1,351.83 euro, kontributet e paguara nga punëdhënësi 1,351.83 euro, kontributet totale të dërguara 2,703.66 euro; Ankesë e paditësit e parashtruar Komisionit për Shqyrtim të Ankesave të paditurës përmes email-it me datë 19.01.2021, kundër vendimeve të Qeverisë Nr.10/33, Nr. 14/34 si dhe Nr. 1/35 për subvencionimin e bizneseve; Paditësi përmes emailit të datës 05.03.2021 drejtuar të paditurit ka sqaruar se ankesën të cilën e kanë parashtruar në Komisionin e Ankesave në Ministrinë e Financave e njëjta ankesë është parashtruar lidhur me vendimet e Qeverisë Nr. 10/33, Nr. 14/34 si dhe Nr. 1/35 për subvencionimin e bizneseve në bazë të kriterit të bazuar në numrin e të punësuarve për bizneset e regjistruara para vitit 2020.
2. Vendimi i Komisionit të Ankesave të datës 19.04.2021, me të cilin i është refuzuar ankesa e paditësit si e pa bazuar me arsyetim se paditësi si tatim pagues nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara në Vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr. 10/33, 14/34, 01/35 dhe 03/59 me konkretisht kriteret si:(1) të kenë statusin e tatimpaguesit aktiv në muajin Korrik 2020 në Agjencinë Tatimore të Kosovës (tutje referuar ATK), dhe të kenë të dorëzuar deklaratën vjetore, tremujore dhe deklaratën për

tatimin e mbajtur në burim në paga sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me vendimin Nr. 10/33 nën par. 1.1, (2) për bizneset aktive që deklaratën tatimore nuk e kanë dorëzuar përmes EDI, kërkohen dëshmitë bankare se pagesa e detyrimeve tatimore është realizuar para datës 28.09.2020 në përputhje me vendimin Nr. 03/59 nën par. 2.2. Pas verifikimit në Sistemin e Administratës Tatimore të Kosovës Komisioni i Ankesave ka konstatuar se paditësi si tatimpagues nuk e ka dorëzuar deklaratën tatimore vjetore dhe/ ose deklaratën tre mujore dhe/ose deklaratën për tatimin e mbajtur në burim në paga deri më datë 28.09.2020, si dhe nuk ka dorëzuar dëshmi bankare që i ka kryer obligimet tatimore para datës 28.09.2020 sikurse specifikohet në vendimin nr. 03/59 par.2.2

3. Paditësi përmes e- mailit të datës 14.09.2021 ka kërkuar kërkesë për informata, duke bashkangjitur CD-Formularin e Deklarimit Vjetor për vitin 2019 me arsyetim se më datë 12.04.2021 përmes e-mailit e paditura konkretisht ka njoftuar paditësin se ankesa e tyre është duke u shqyrtuar, ndërsa është ka konstatuar se në sistemin e Administratës Tatimore të Kosovës ju mungon deklarata vjetore tatimore PD ose CD (varësisht nga statusi i biznesit) e vitit 2019, ndërsa paditësi përmes emailit të datës 13.04.2021 pretendon se i ka bashkangjitur CD-Formularin e Deklarimit Vjetor për vitin 2019.
4. Përmes kërkesës së datës 27.09.2021 paditësi ka kërkuar nga Ministria e Financave nxjerrjen e aktit administrativ të miratuar në heshtje konform nenit 100 të Ligjit për Konfliktin Administrativ(LKA) sipas Kërkesës për shqyrtim në lidhje me subvencionimin për linjën e pagave për Apartament 197 Group L.L.C.
5. Nga Përgjigje e MFPT më datë 26.10.2021 me nr.prot 1671-1/21, përmes kësaj përgjigje Ministria e Financave Punës dhe Transfereve ka njoftuar tani paditësin se pretendimet e tij nuk janë të bazuara ndërsa neni 100 i LPPA-së nuk mund të aplikohet duke qenë se akti i kërkuar nga parashtruesi tani paditësi i është njoftuar palës në formë të vendimit të datës 19.04.2021, përmes të cilit vendim Komisioni i Ankesave e ka refuzuar ankesën si të pa bazuar me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës nuk i ka përmbushur të gjitha kriteret.
6. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përmes e-mail me datë 21.06.2024, ka sqaruar se pala ankimore tani paditësi nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara sipas vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr. 10/33, 14/34 dhe 01/35, më

konkretisht kriteret si: (1) të kenë statusin e tatimpaguesit aktiv në muajin Korrik 2020 në Agjencinë Tatimore të Kosovës (tutje referuar ATK), dhe të kenë të dorëzuar deklaratën vjetore, tremujore dhe deklaratën për tatimin e mbajtur në burim në paga sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me vendimin Nr. 10/33 nën par. 1.1, (2) për bizneset aktive që deklaratën tatimore nuk e kanë dorëzuar përmes EDI, kërkohen dëshmitë bankare se pagesa e detyrimeve tatimore është realizuar para datës 28.09.2020 në përputhje me vendimin Nr. 03/59 nën par. 2.2. Bazuar në datën e regjistrimit të biznesit si datë 11.09.2017 ky tatimpagues për të përfituar subvencionimin është dashur të ketë të deklaruar në ATK deri më datë 28.09.2020 deklaratën vjetore CD për Tatim në të Ardhura të Korporatave për periudhën 2019, mirëpo tatimpaguesi këtë deklaratë e ka dorëzuar apo deklaruar më datë 13.04.2021, e cila shihet edhe te detajet e vlerësimit nga Sistemi i Administratës Tatimore të Kosovës, ku Deklarata CD për Tatim në të Ardhura të Korporatave për periudhën 2019 nga tatim paguesi “Aparment 197 Group”, L.L.C., është deklaruar më datë 13.04.2021.

Vlerësimi i Gjykatës

7. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenit 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, përgjigjen e të paditurës në padi, deklaratimet e tyre në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar.
8. Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 10/33 i datës 28.09.2020, i plotësuar dhe i ndryshuar me vendimin Nr. 14/34 të datës 07.10.2020, dhe vendimit Nr. 01/35 të datës 12.10.2020 në pikën I të këtij vendimi ka aprovuar ndarjen e mjeteve buxhetore për zbatimin e programit të Rimëkëmbjes Ekonomike në vlerë prej tetëdhjetë e shtatë milion euro (87,000,000.00 euro) nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike me kod 29300, kategoria e shpenzimeve “Subvencione dhe Transfere” për organizatat buxhetore dhe masat e programit në vijim: Në pikën 1.1 është përcaktuar që *në Ministrinë e Ekonomikë dhe Ambientit me kod 213 në nën programin Ndërmarrësia me kod 49400, ndahen gjashtëdhjetë milion euro (60,000,000 euro). Ndarja e mjeteve bëhet për subvencionimin e linjës së pagave për bizneset aktive, bazuar në numrin e të punësuarve të deklaruar në deklaratën e tatimit në pagë të muajit dhjetor 2019, që plotësojnë kushtet si në vijim: -Të*

kenë statusin e tatim paguesit aktiv në muajin korrik 2020 në sistemin e Administratës Tatimore të Kosovës si dhe të kenë të dorëzuar deklaratën vjetore, tremujore dhe deklaratën për tatimin e mbajtur në burim nga paga, sipas legjislacionit në fuqi. Në pikën 1.1.1 është përcaktuar se subvencionimi nga pika 1.1 e këtij vendimi përfshin edhe bizneset e regjistruara gjatë periudhës janar-gusht 2020. Në këtë rast subvencionimi bazohet në numrin e të punësuarve të deklaruar për muajin korrik 2020.

9. *Vendimi i Qeverisë Nr. 03/59 i datës 21.01.2021, në pikën 1. është aprovuar ndarja e mjeteve buxhetore për zbatimin e Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike në vlerë prej gjashtëmilion e pesëqind mijë euro (6,500,000.00 euro) për subvencionimin e bizneseve aktive dhe të vetë të punësuarve, si vazhdimësi e vendimeve Nr. 10/33 të datës 28.09.2020, Nr. 14/34 të datës 07.10.2020 dhe vendimit Nr. 01/35 i datës 12.10.2020. Në pikën 2 është përcaktuar që subvencionimin e linjës së pagave apo çekut të pagave për bizneset aktive dhe të vetëpunësuarit sipas kuotës së njëjtë 290.06 dhe kriterëve të përcaktuara nga Komisioni ndër-ministror sipas pikës 7 të këtij vendimi, bazohet në kriteret e vendimit të Qeverisë Nr. 10/33 të datës 28.09.2020, lidhur me pikën 1 i plotësuar dhe ndryshuar me vendimin Nr. 14/34 të datës 07.10.2020, dhe vendimin Nr. 01/35 i datës 12.10.202, me përjashtimet si në vijim: në pikën 2.2 është përcaktuar se: për bizneset aktive që deklaratën tatimore nuk e kanë dorëzuar përmes sistemit EDI, kërkohen dëshmitë bankare se pagesa e detyrimeve është realizuar para datës 28.09.2020.*
10. *Gjykata shqyrtoj ligjshmërinë e vendimit të kundërshtuar në në kuptim të nenin 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative.*
11. *Nga provat administruara në këtë çështje të konfliktit administrativ gjykata konstatoj se e paditura përmes vendimit të kundërshtuar ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike pasi që lidhur me refuzimin e ankesës së paditësit e paditura është bazuar në kriteret e përcaktuara në Vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr. 10/33, 14/34, 01/35 dhe 03/59 me konkretisht kriteret si:(1) të kenë statusin e tatimpaguesit aktiv në muajin Korrik 2020 në Agjencinë Tatimore të Kosovës (tutje*

referuar ATK) dhe të kenë të dorëzuar deklaratën vjetore, tremujore dhe deklaratën për tatimin e mbajtur në burim në paga sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me vendimin Nr. 10/33 nën par. 1.1, (2) për bizneset aktive që deklaratën tatimore nuk e kanë dorëzuar përmes EDI, kërkohen dëshmitë bankare se pagesa e detyrimeve tatimore është realizuar para datës 28.09.2020 në përputhje me vendimin Nr. 03/59 nën par. 2.2.,

12. Rrjedhimisht, në vendimin e kontestuar nga e paditura ishte konstatuar që pas verifikimit në Sistemin e Administratës Tatimore të Kosovës Komisioni i Ankesave ka konstatuar se paditësi si tatimpagues nuk e ka dorëzuar deklaratën tatimore vjetore dhe/ ose deklaratën tre mujore dhe/ose deklaratën për tatimin e mbajtur në burim në paga deri më datë 28.09.2020, si dhe nuk ka dorëzuar dëshmi bankare që i ka kryer obligimet tatimore para datës 28.09.2020 sikurse specifikohet në vendimin nr. 03/59 par.2.2, siç konstatohet në komunikimin në mes paditësit dhe përfaqësuesit të paditurës. Ashtu që më datë 12.04.2021 përmes emailit e paditura konkretisht kishte njoftuar paditësin se ankesa e tyre është duke u shqyrtuar, ndërsa në sistemin e Administratës Tatimore të Kosovës ju mungon deklarata vjetore tatimore PD ose CD e paditësit, ndërsa paditësi përmes e-mailit të datës 13.04.2021 ka bashkangjitur CD-Formularin e Deklarimit Vjetor për vitin 2019 duke e njoftuar të paditurën për bashkangjitjen e CD-Formularin e Deklarimit Vjetor për vitin 2019.
13. Në rastin konkret, gjykata vlerëson se paditësi përveç që ka bashkangjitur si prova në shkresat e lëndës fletëpagesat për periudhën 12/2019 të realizuara më datë 15.01.2020, mirëpo i njëjti nuk ka arritur që të dëshmoj se deklaratën vjetore tatimore PD ose CD (varësisht nga statusi i biznesit) e vitit 2019 e ka dërguar në sistemin e Administratës Tatimore të Kosovës para datës 28.09.2020, siç është përcaktuar si kriter në vendimin e Qeverisë nr. Nr. 03/59 i datës 21.01.2021, apo se para datës 28.09.2020 të ketë ka dërguar dëshmitë bankare se pagesa e detyrimeve është realizuar para kësaj date.
14. Andaj gjykata duke pasur parasysh se nga detajet e vlerësimit në Sistemin e Administratës Tatimore të Kosovës, e bashkangjitur si provë materiale në shkresat e lëndës Deklarata CD për Tatim në të Ardhura të Korporatave për periudhën 2019 nga paditësi “Apartment 197 Group”, L.L.C., është deklaruar më datë 13.04.2021, kanë të bëjnë për periudhën 12/2019 të realizuara më datë 15.01.2020, mirëpo i njëjti nuk ka arritur që të dëshmoj se deklaratën vjetore tatimore PD ose CD (varësisht nga statusi i

biznesit) e vitit 2019 e ka dërguar në sistemin e Administratës Tatimore të Kosovës para datës 28.09.2020, vlerëson se Vendimi i Komisionit të Ankesave të datës 19.04.2021, me të cilin i është refuzuar ankesa e paditësit si e pa bazuar me arsyetim se paditësi si tatim pagues nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara në Vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr. 10/33, 14/34, 01/35 dhe 03/59 është marrë në konstatim të drejtë të gjendjes faktike.

15. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.695/22, datë 21.10.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.